



Perspektiva juaj
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve

Raport Muaji Prill 2024

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	20 Gusht 2018
Datë e mbarimit te Ofertes	03 Shtator 2018
Fillestare	
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	30,000
Shuma minimale pasuese	10,000

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	2% (cdo shlyerje para 2 viteve)
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve

Tarifa te tjera te vazhdueshme

Komisione/tarifa e vazhdueshme

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta

Referojuni prospektit te fondit

1.28% per vitin 2023

Referojuni informacionit ne degjet e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

Shifra e tarifas së vazhdueshme 1.28% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2023. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.


Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i Riskut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit. Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 30.04.2024

Vlera Neto e Aseteve	8,710,694,706
Numri i investitoreve	3,497
Cmimi i Kuotes	1,176.5121
*Kthimi vjetor neto nga investimi (30.04.2023 – 30.04.2024)	3.54%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 30 Prill 2024



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar. Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 8.7 miliardë në datë 30 Prill 2024.

Instrumenti	Në % të Aseteve të Fondit
Obligacione Thesari	84.7%
Bono Thesari	1.7%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme	13.6%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afersisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Prill


Ne Prill norma bazë e interesit eshte e pandryshuar në nivelin 3.25%. Norma e inflacionit vazhdoi me rënie te metejshme ne nivelin 2.10% ne krahasim me 2.30% qe ishte ne muajin Mars. Ky eshte niveli me i ulet i inflacionit ne keto dy vitet e fundit. Asetet e Fondit Vizion jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikës se Shqipërisë dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve.

Normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare kane ndjekur nje trend pergjithesisht renes gjate muajit Prill pervec Bonos 12-mujore dhe Obligacionit 2-vjecar te cilet nuk kane pesuar ndryshime te rendesishme.

Yieldi i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 3.657%, duke u rritur lehte me 0.01% ne krahasim me ankandin e muajit Mars dhe yieldi i obligacionit 2 vjecar rezultoi ne 4.29% duke u rritur me 0.06% ne krahasim me ankandin e fundit.

Ndersa yieldet e obligacioneve reference 3 dhe 5-vjecar rezultuan ne 4.516% dhe 5.216% duke rënë perkatesisht me 0.31% dhe 0.26% krahasuar me ankandet e fundit. Gjithashtu yieldi i obligacionit 10 vjecar rezultoi ne 6.36% duke rënë me 0.42% ne krahasim me ankandin e fundit.

Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Prill 2023 – Prill 2024. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yield-et fikse te perlllogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Prill.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 30 Prill 2024

Kthimi neto me baze vjetore, per periudhen 30 Prill 2023 – 30 Prill 2024 eshte **3.54%.**

Çmimi i kuotes se fondit Vizion eshte rritur me **+0.94%** gjate muajit Prill.


Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatsmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.

Ecuria e çmimit të kuotes Fondi Raiffeisen Vizion



Ne 30 Prill 2024	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (3 Shtator 2018)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	3.54%	2.27%	2.33%	2.30%	2.91%

Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Vizion për çdo vit



Fondi Vizion aplikon një periudhë minimale qëndrimi në fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje përpara përmbushjes së periudhës 2-vjet, do të jetë subjekt i një tarife dalese prej 2% e vlerës së kuotave të shlyera.

Pertëj minimumit kohor të qëndrimit në fond, Investitorët e fondit Vizion dhe të gjithë fondetë të administruara nga Raiffeisen Invest këshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Për fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qëndrimit në fond është të paktën 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe në mënyrë që të përmbushet objektivi i performancës së fondit.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond, sepse në këtë mënyrë nuk do të rrezikojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Të dhënat për kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.